Udhëzues për klientët e integrimit në shërbimet e punësimit

Elinkeino-, liikenne- ja ympäristökeskus

Kumppanina kotoutumisessa

Euroopan unionin osarahoittama

Udhëzues për klientët e integrimit në shërbimet e punësimit

Synimi i shoqërisë finlandeze është të ndihmojë njerëzit që kanë migruar në Finlandë të integrohen me sukses. Të integrohesh do të thotë të mësosh të jetosh dhe të punosh në shoqërinë finlandeze. Qëllimi është gjithashtu t'ju ndihmojë të gjeni punë ose të studioni në mënyrë që integrimi juaj të fillojë sa më shpejt.

Synimi i shërbimeve të punësimit është të rritë shanset tuaja për të gjetur një punë ose për të filluar apo vazhduar shkollimin.

Periudha e Integrimit dhe Plani i Integrimit

Sipas ligjit, juve iu përgatitet plani për integrim si klient i ri, sipas nevojës. Kohëzgjatja e planit të integrimit përcaktohet individualisht për çdo person. Zakonisht zgjat dy vjet.

Sipas ligjit, plani i integrimit duhet të përgatitet brenda tre viteve nga marrja e lejes së parë të qëndrimit ose nga regjistrimi i së drejtës suaj për të qëndruar.

Në planin e integrimit do të tregohen me hollësi shërbimet që do t'ju nevojiten gjatë viteve të para në Finlandë. Për shembull, këto shërbime mund të përfshijnë kurse të gjuhës finlandeze ose suedeze.

Nëse keni nevojë për shërbime punësimi pas përfundimit të periudhës së integrimit, do të përgatitet një plan punësimi për t'ju ndihmuar me punësimin.

Më tej në këtë manual jepet më shumë informacion rreth planit të integrimit.

Orientimi qytetar shumëgjuhësh

Në fillim të integrimit tuaj, do të ftoheni të merrni pjesë në një trajnim, në të cilin do të merrni informacion rreth shoqërisë finlandeze në gjuhën tuaj amtare ose në një gjuhë tjetër që dini. Ky trajnim quhet orientimi qytetar. Zakonisht zgjat disa javë.

Mirë se vini në shërbimet e punësimit!

Qëllimi i krijimit të një lidhjeje si klient me shërbimet e punësimit është t'ju ndihmojë të gjeni një punë. Shërbimet e punësimit do t'ju japin informacion në lidhje me vendet e lira të punës. Shërbimet e punësimit do t'ju ndihmojnë gjithashtu të kërkoni punë.

Shërbimet e punësimit mund t'ju referojnë në trajnime integrimi, prova për vende pune ose trajnime, ose punësim të subvencionuar, ose mund t'ju ofrojnë trajnime se si të kërkoni punë, si të bëni karrierë, si edhe trajnim për punë. Gjithashtu mund të merrni këshilla dhe informacione për të filluar biznesin tuaj.

Vendimet e marra nga shërbimet e punësimit dhe stafi i tij bazohen gjithmonë në legjislacion (Ligji i Procedurës Administrative, Ligji për Punësimin Publik dhe Shërbimit të Biznesit, Ligji për Sigurimin për të Papunët dhe Ligji për Nxitjen e Integrimit të Emigrantëve).

Si mund të bëhem klient i shërbimeve të punësimit?

Për të marrë shërbime punësimi, siç janë trajnimet e integrimit, duhet të regjistroheni si punëkërkues në shërbimet e punësimit. Mund të regjistroheni si punëkërkues në faqen e internetit tyomarkkinatori.fi. Faqja e internetit ofrohet në finlandisht dhe suedisht, dhe disa materiale ofrohen edhe në anglisht. Nëse nuk jeni në gjendje të regjistroheni si punëkërkues në internet, mund të shkoni te zyra lokale e shërbimeve të punësimit për t'u regjistruar.

Pas regjistrimit, shërbimet e punësimit do t'ju kontaktojnë.

Kur shkoni te shërbimet e punësimit për herë të parë, ju lutemi të merrni me vete dokumentet e mëposhtme:

- Pasaportë ose kartë identiteti kombëtare
- Leje qëndrimi ose certifikatë regjistrimi për të drejtën e qëndrimit, të lëshuar nga policia për shtetasit e BE-së
- Nëse është e mundur, një ekstrakt i regjistrit të popullsisë nga Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të Dhënave të Popullsisë (DVV) ose një dokument që vërteton se keni një kod identiteti personal finlandez.

Gjithashtu merrni çdo certifikatë ose diplomë të arsimimit dhe eksperiencës suaj në punë.

Çfarë ndodh pasi të jem regjistruar si punëkërkues?

Një punonjës i shërbimeve të punësimit do të lërë një takim me ju për të vlerësuar nevojat tuaja. Gjatë këtij takimi do të diskutojmë për aftësitë tuaja dhe synimet për karrierë. Përveç vlerësimit të nevojave tuaja, zakonisht përgatitim edhe një plan integrimi për ju.

Nëse keni fëmijë, ju lutemi të merrni masa që dikush të kujdeset për fëmijët gjatë kohës së takimit me shërbimet e punësimit. Nëse nuk flisni finlandisht ose suedisht, do t'ju ofrohet një përkthyes nëse është e nevojshme.

Plani i integrimit përgatitet së bashku me ju

Një oficer i shërbimeve të punësimit do të përgatitë një plan integrimi së bashku me ju. Në planin e integrimit do të tregohet nëse do të studioni finlandisht ose suedisht gjatë periudhës së integrimit, llojin e punës që do të kërkoni dhe çfarë lloj trajnimi integrimi ose shërbime të tjera ndihmëse punësimi do t'ju nevojiten. Shërbimet për të cilat është rënë dakord në plan duhet të nxisin integrimin tuaj siç kërkohet me ligj. Plani do të marrë parasysh arsimin, eksperiencën në punë, shëndetin tuaj, si dhe faktorë të tjerë personalë.

Trajnimi i integrimit ofrohet në finlandisht ose suedisht. Për të përcaktuar trajnimin më të përshtatshëm për ju, kryhet një vlerësim. Kjo bëhet në shumicën e fushave përmes një testi për nivelin fillestar të aftësive gjuhësore. Ky test do të përcaktojë se cili lloj trajnim integrimi do t'ju nevojitet. Testi zakonisht zgjat disa orë. Nuk kërkohet të dini ndonjë finlandisht ose suedisht që të bëni testin.

Një punonjës i shërbimeve të punësimit do t'ju shpjegojë se si funksionon ky proces në zonën tuaj.

Kërkesa për gjetjen e punës do të tregohet gjithashtu te plani i integrimit.

Cila është kërkesa për të kërkuar punë? Çfarë do të thotë kjo?

Kërkesa për të gjetur punë nënkupton që, si punëkërkues i papunë, ju duhet të aplikoni për 1-4 vende pune në muaj, në varësi të rrethanave tuaja. Numri minimal i aplikimeve për punë do të vendoset individualisht për ju, dhe ju keni lirinë të zgjidhni se për cilat vende pune do të aplikoni. Kërkesa juaj për të gjetur punë do të rishikohet sa herë që plani juaj të përditësohet. Pasi të keni aplikuar për një vend pune, duhet të informoni shërbimet e punësimit lidhur me punën për të cilën keni aplikuar brenda afatit të fundit. Për aatet do të bihet dakord në planin tuaj të integrimit.

Mënyra më e lehtë për të raportuar në lidhje me kërkimin e punës është nëpërmjet seksionit ”Asiointi” të faqes së internetit të Työmarkkinatori, nëse mund të flisni finlandisht ose suedisht dhe keni kredenciale bankare online. Nëse nuk jeni në gjendje të përdorni shërbimin online, mund të bini dakord për një mënyrë alternative me punonjësin e shërbimeve të punësimit. Ju lutemi specifikoni se për cilën punë keni aplikuar, si keni aplikuar dhe ku.

Nëse nuk e ke përmbushur detyrimin tënd për kërkimin e punës, është e mundur që pagesa e përfitimit tënd të papunësisë të pezullohet.

Trajnimi i integrimit

Ofrohet trajnim i integrimit për të ndihmuar të sapoardhurit në Finlandë që të mësojnë gjuhën dhe të fitojnë aftësitë dhe njohuritë që u duhen për të gjetur një vend pune ose studimi. Trajnimi i integrimit zakonisht ofrohet në finlandisht, por në disa fusha mund të ofrohet edhe në suedisht.

Kur mund të filloj trajnimin e integrimit?

Do të merrni një letër nga shërbimet e punësimit kur të jetë i disponueshëm një vend i përshtatshëm në një trajnim integrimi. Në letër do t'ju tregohet se kur dhe ku do të fillojë trajnimi. Duhet të jeni të përgatitur se institucioni që ofron trajnimin e integrimit mund të mos jetë shumë afër shtëpisë tuaj. Nëse nuk flisni finlandisht ose suedisht, zakonisht trajnimi i integrimit do të zgjasë rreth një vit. Në varësi të vendndodhjes suaj, trajnimi mund të jetë i vazhdueshëm ose mund të ketë ndërprerje ndërmjet seksioneve.

Nuk është gjithmonë e mundur të filloni menjëherë një trajnim integrimi. Mund të ketë një listë të gjatë pritjeje për trajnimin. Është e rëndësishme të filloni trajnimin dhe të merrni pjesë rregullisht pasi të merrni ftesën. Nëse nuk e filloni trajnimin e integrimit dhe nuk keni një arsye të vlefshme, mund t'ju bëhet një kërkesë që të jepni sqarim. Përfitimet tuaja të papunësisë gjithashtu mund të pezullohen.

Si është trajnimi i integrimit?

Trajnimi i integrimit i organizuar nga shërbimet e punësimit zakonisht përfshin studimin pesë ditë në javë. Kohëzgjatja e çdo dite studimi ndryshon në varësi të zonës. Zakonisht zgjat 5-7 orë mësim në ditë. Në trajnimin e integrimit, mësuesi do të flasë finlandisht ose suedisht, në varësi të gjuhës që studioni. Një pjesë e mësimit zhvillohet në klasë, ndërsa një pjesë bëhet në shtëpi. Trajnimi mund të ofrohet edhe online, duke ju dhënë mundësi të studioni nga shtëpia me anë të një kompjuteri.

Trajnimi i integrimit përfshin një ose më shumë caktime në punë. Gjatë këtyre caktimeve do të fitoni përvojë pune në një vend pune në Finlandë. Në fund të trajnimit të integrimit, do të bëhet një test përfundimtar për aftësitë gjuhësore.

Sa kushton trajnimi?

Trajnimi i integrimit është pa pagesë. Gjatë trajnimit, zakonisht do të merrni përfitime për papunësi dhe një kompensim për udhëtimin për ditët e trajnimit. Qëllimi i kompensimit për udhëtimin (9 € për ditë studimi) është që të mbulojë të paktën disa nga shpenzimet tuaja për udhëtimin dhe ushqimin. Për informacion më të hollësishëm rreth përfitimeve gjatë trajnimit, ju lutemi kontaktoni punonjësin e shërbimeve të punësimit, Kela, ose fondin e papunësisë.

Çfarë duhet të bëj nëse e kam të nevojshme të mungoj në trajnimin e integrimit?

Ju duhet të merrni pjesë në trajnimin e integrimit në të gjitha ditët e mësimit. Mungesat nuk lejohen pa marrë leje më përpara ose pa pasur arsye të vlefshme. Nëse jeni sëmurë, informoni gjithmonë mësuesin. Mësuesi mund t'ju kërkojë gjithashtu një vërtetim mjekësor të lëshuar nga një mjek ose infermier. Nëse mungoni në trajnim për pesë ditë ose më shumë pa leje ose pa pasur një arsye të vlefshme, kursi juaj mund të ndërpritet. Në këtë rast, do t'ju duhet të prisni të fillojë kursi tjetër. Përfitimet tuaja të papunësisë gjithashtu mund të pezullohen. Nëse caktoheni në një program tjetër trajnimi gjatë trajnimit të integrimit, nuk duhet të filloni studimet derisa të keni diskutuar për këtë me shërbimet e punësimit.

A mund të studioj diku tjetër përveç trajnimit të integrimit të organizuar nga shërbimet e punësimit?

Ju mund të merrni pjesë gjithashtu në një kurs të gjuhës finlandeze ose suedeze që nuk organizohet nga shërbimet e punësimit, por fillimisht duhet të diskutoni për këtë me shërbimet e punësimit. **Mos filloni studimet derisa të keni diskutuar për këtë me shërbimet e punësimit.**

Mund t'i gjeni kurset në faqe interneti të tilla si, kotoutumisentukena.fi, kielibuusti.fi, finnishcourses.fi dhe infofinland.fi/finnish and swedish online.

Gjatë periudhës së integrimit mund të merrni përfitime për papunësi dhe një kompensim udhëtimi për pjesë të caktuara të trajnimit. Për shembull, arsimi për shkrim-lexim zakonisht zgjat një vit dhe arsimi bazë për të rriturit zgjat deri në katër vjet.

Ka shumë rregulla në lidhje me ndihmën për studimet e nisura vetë gjatë periudhës së integrimit. Pyesni një punonjës të shërbimeve të punësimit për më shumë informacion lidhur me kushtet dhe kohëzgjatjen e ndihmës për studimet e nisura vetë.

Gjithashtu studioni finlandisht ose suedisht në mënyrë aktive dhe të pavarur. Mund të gjeni materiale të përshtatshme studimi, për shembull në biblioteka dhe në internet.

Si mund ta mbaj aktiv statusin tim si klient i shërbimeve të punësimit?

Mund të ruani statusin si klient me shërbimet e punësimit duke qëndruar në kontakt me përgjegjësin e shërbimeve të punësimit siç keni rënë dakord (p.sh. me telefon, email ose online). Gjithashtu mund të ftoheni të shkoni te zyra shërbimeve të punësimit. Duhet të shkoni në takim në orarin e caktuar. Nëse orari i caktuar nuk është i përshtatshëm për ju, duhet të kontaktoni shërbimet e punësimit për të lënë një orar tjetër.

Çfarë duhet të mbaj parasysh ndërkohë që jam punëkërkues me shërbimet e punësimit?

Nëse planifikoni të aplikoni për një kurs, trajnim ose arsim që e keni gjetur vetë dhe që do t'ju ndihmojë të gjeni punë, informoni gjithmonë shërbimet e punësimit ose diskutoni për këtë me punonjësin e shërbimeve të punësimit. Kontaktoni gjithmonë shërbimet e punësimit nëse situata juaj ndryshon dhe plani juaj duhet të përditësohet. Në këtë mënyrë do të mësoni se si shërbimet që keni kërkuar do të ndikojnë te përfitimet tuaja për papunësi, për shembull.

- Informoni shërbimet e punësimit duke shkuar personalisht, duke i kontaktuar me telefon ose email, ose nëpërmjet seksionit "Asiointi" të Työmarkkinatori, nëse:

- gjeni punë
- gjeni një punë me kohë të pjesshme
- ju ndryshon adresa ose numri i telefonit
- filloni leje lindjeje ose merrni raport nga mjeku
- nuk jeni në gjendje të punoni ose të merrni pjesë në trajnime për ndonjë arsye
- keni ndërmend të merrni pjesë në ndonjë trajnim që organizohet nga një palë tjetër, përveç shërbimeve të punësimit
- ju ose një pjesëtar i ngushtë i familjes do të fillojë ose ndërpresë veprimtaritë e biznesit
- bëheni kujdestar fëmije
- dëshironi të bëni pushime ose të udhëtoni jashtë shtetit apo të ktheheni në vendin tuaj
- keni ndërmend të transferoheni jashtë shtetit
- ose nuk dëshironi të kërkoni punë për ndonjë arsye tjetër.

- Kërkoni punë në mënyrë aktive dhe përgatituni të pranoni punën ose trajnimin që ju ofrohet nga shërbimet e punësimit.

- Mund të ftoheni në një takim, për shembull, për të përditësuar planin tuaj. Ju lutemi të vini në zyrën e shërbimeve të punësimit në orarin e caktuar ose na njoftoni paraprakisht nëse nuk mund të merrni pjesë. Nëse nuk merrni pjesë në takim dhe nuk na njoftoni paraprakisht, mund të tarifoheni për kohën e pashfrytëzuar të përkthimit. Përveç kësaj, nëse nuk paraqiteni në një takim të planifikuar mund të ndikojë te pagesa e përfitimeve tuaja për papunësi ose te vlefshmëria e statusit tuaj si punëkërkues me shërbimet e punësimit.

- Sigurohuni që leja e qëndrimit dhe pasaporta juaj janë të vlefshme. Aplikoni për leje të re qëndrimi para se të skadojë ajo aktuale. Paraqisni dëshmi në shërbimet e punësimit që keni aplikuar për një leje qëndrimi të re.

- Pasi të merrni lejen tuaj të re të qëndrimit, paraqiteni te shërbimi i klientit i shërbimeve të punësimit. Nëse leja juaj e qëndrimit nuk është e vlefshme dhe nuk keni aplikuar në kohë për një të re, përfitimet tuaja për papunësi do të ndërpriten dhe marrëdhënia juaj si klient me shërbimet e punësimit do të përfundojë. Mund të riregjistroheni si klient vetëm pasi të merret një vendim pozitiv për lejen tuaj të qëndrimit. Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të shërbimit të imigracionit finlandez.

Gjithashtu, na njoftoni nëse leja e qëndrimit ose leja juaj e punës ndryshon ose nëse leja e qëndrimit ju anulohet për ndonjë arsye.

Çfarë duhet të bëj nëse më bëhet një kërkesë për të dhënë sqarime?

Nëse merrni një letër nga shërbimet e punësimit që kërkon sqarime, përgjigjuni gjithmonë. Na dërgoni të gjitha dokumentet që ju kërkojmë. Keni dy javë kohë për t'iu përgjigjur kërkesës për sqarime. Gjithashtu mund t'i përgjigjeni kërkesës për sqarime nëpërmjet seksionit "Asiointi" në faqen e internetit të Työmarkkinatori. Shërbimi ndaj klientit i shërbimeve të punësimit dhe punonjësi i shërbimeve të punësimit mund t'ju ndihmojnë nëse keni ndonjë pyetje.

Pyetje të bëra shpesh?

Çfarë është përfitimi për papunësi?

Përfitimi për papunësi është ndihmë financiare që u ofrohet personave që kërkojnë në mënyrë aktive punë me kohë të plotë. Duhet të jeni aktivë në kërkimin e punës me qëllim që të merrni përfitimin për papunësi.

Kush e bën pagesën për papunësi?

Përfitimi për papunësi paguhet nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore të Finlandës (Kela) dhe fondet e papunësisë. Shërbimet e punësimit i dërgojnë një deklaratë Kela-s ose fondit të papunësisë në lidhje me kualifikimin tuaj për të marrë përfitimin. Në deklaratë, shërbimet e punësimit tregojnë nëse keni të drejtë për përfitimin për papunësi sipas këndvështrimit të tyre. Megjithatë, vendimi përfundimtar nëse do të paguhet apo jo përfitimi i takon Kela-s ose fondit të papunësisë. Gjithashtu, shërbimet e punësimit nuk mund t'ju tregojnë se kur Kela do të paguajë përfitimin tuaj për papunësi. Për këtë duhet të pyesni Kela-n.

Për të marrë përfitim për papunësi, duhet të aplikoni vetë për të nga Kela ose nga fondi i papunësisë. Mund të aplikoni për përfitimin duke plotësuar një aplikim online në faqen e internetit të Kela (www.kela.fi) ose në faqen e internetit të fondit të papunësisë. Gjithashtu mund të aplikoni për përfitimin e papunësisë duke përdorur një formular në letër, të cilin mund ta merrni ose t'ia dërgoni Kela-s ose fondin të papunësisë.

Mbi cilat baza bëhet pagesa për papunësi?

Përfitimi për papunësi mund të paguhet vetëm nëse jeni klient i shërbimeve të punësimit dhe jeni i gatshëm të punoni me kohë të plotë. Gjithashtu duhet të jeni të gatshëm të pranoni punë me kohë të pjesshme. Ndonjëherë, edhe njerëzit që punojnë me kohë të pjesshme mund të kenë të drejtë për përfitime papunësie.

Në përgjithësi, puna me kohë të plotë nënkupton të punosh pesë ditë në javë për tetë orë në ditë, ose rreth 40 orë në javë. Nëse nuk mund të gjeni punë, duhet të pranoni shërbimet e ofruara nga shërbimet e punësimit të tilla si, pjesëmarrja në trajnime me kohë të plotë.

Përfitimet për papunësi nuk paguhen nëse jeni student me kohë të plotë në një program që nuk është organizuar ose miratuar nga shërbimet e punësimit. Gjithashtu nuk paguhet nëse nuk jeni në gjendje të punoni me orar të plotë për ndonjë arsye tjetër. Një arsye tjetër mund të jetë, për shembull, kujdesi për fëmijët në kohë të plotë. Të jesh i vetëpunësuar mund të ndikojë gjithashtu te pagesa e përfitimeve për papunësi.



Si mund të gjej punë?

Si klient i shërbimeve të punësimit, detyra juaj është të kërkoni punë në mënyrë aktive. Shërbimet e punësimit nuk mund t'ju ofrojnë punë, por do t'ju mbështesin ndërsa kërkoni punë. Shërbimet e punësimit do t'ju ofrojnë informacion në lidhje me vendet e punës që janë të përshtatshme për ju.

Zakonisht, punëdhënësit i reklamojnë në internet vendet e punës. Për shembull, mund të gjeni vende pune në faqen e internetit Työmarkkinatori (tyomarkkinatori.fi). Vendet e punës reklamohen edhe në faqe të tjera interneti. Gjithashtu mund të gjeni punë përmes agjencive të personelit ose rrjetit tuaj personal. Gjithashtu mund të krijoni një profil si punëkërkues në Työmarkkinatori. Për më tepër, ju mund ta ruani profilin tuaj në format PDF ose ta printoni, dhe ai do të shërbejë si CV-ja juaj. Mund të krijoni profilin tuaj si punëkërkues duke hyrë në Työmarkkinatori. Gjithashtu mund të merrni pjesë në evente të marrjes në punë. Gjithashtu, krijimi i lidhjeve me persona të tjerë, për shembull nëpërmjet hobive, mund t'ju ndihmojë të gjeni punë.

Si mund të aplikoj për punë?

Te reklama për vendin e punës do të tregohet se si të kontaktoni punëdhënësin. Zakonisht aplikimet për punë bëhen në mënyrë elektronike nëpërmjet një formulari online. Përndryshe, mund t'ju duhet t'i dërgoni punëdhënësit një aplikim për punë dhe CV-në tuaj. Shpjegoni shkurtimisht në aplikimin tuaj:

- pse jeni të interesuar për vendin e hapur punës
- pse mendoni që jeni të përshtatshëm për këtë vend pune.

Në CV-në tuaj, përfshini

- të dhënat e kontaktit tuaj (emri, numri i telefonit, adresa, adresa e emailit)
- arsimin që keni kryer
- eksperiencën tuaj të mëparshme në punë
- aftësitë tuaja

Për më shumë informacion lidhur me aplikimin për punë dhe shkrimin e CV-ve dhe të aplikimeve për punë: Këshilla për gjetjen e një pune - Kërkimi i punës - Työmarkkinatori (tyomarkkinatori.fi)

Cilat shërbime të tjera ofrojnë shërbimet e punësimit?

Shërbimet e punësimit u ofrojnë gjithashtu punëkërkuesve shërbime të tjera përveç trajnimit për integrim. Gama e shërbimeve të disponueshme ndryshon sipas zonës.

Shërbimet e ofruara nga shërbimet e punësimit

Provë në punë:

- Prova në punë bëhet në një vend pune. Qëllimi është të zbuloni nëse një fushë e caktuar pune do të ishte e përshtatshme për ju.
- Te prova në punë lidhet një marrëveshje mes jush, punëdhënësit dhe shërbimeve të punësimit. Mund të filloni periudhën e provës vetëm pasi të gjitha palët të kenë nënshkruar marrëveshjen dhe një punonjës i qendrës së punësimit të ketë miratuar periudhën e provës dhe të ketë dhënë lejen për fillimin e saj.
- Nuk do të merrni rrogë gjatë periudhës së provës. Në vend të kësaj, zakonisht do të merrni përfitime për papunësi dhe rimbursim për udhëtimin.

Trajnimi:

- Gjatë trajnimit për kërkimin e punës, do të merrni udhëzime se si të kërkoni punë.
- Gjatë orientimit për karrierë, do të merrni ndihmë në lidhje me zgjedhjen e një karriere dhe aplikimin në lidhje me trajnimin për tregun e punës.
- Gjatë stërvitjes për punë, do të merrni ndihmë se si të gjeni punë dhe si të ruani një vend pune.

Trajnimi për tregun e punës:

- Mund të ndiqni një kualifikim ose të plotësoni arsimin që keni aktualisht.
- Gjuha e mësimit në trajnim është finlandishtja ose suedishtja.
- Trajnimi është pa pagesë për ju. Gjatë trajnimit, zakonisht do të merrni përfitime për papunësi dhe rimbursime për udhëtimin.
- Pyesni përgjegjësin e shërbimeve të punësimit për më shumë informacion rreth trajnimit.

Punësimi i subvencionuar:

- Në punësimin e subvencionuar, ju do të punoni në një vend pune. Shërbimet e punësimit do t'i paguajnë punëdhënësit tuaj një subvencion për pagën tuaj.

Udhëzime dhe këshilla për karrierë:

- ju ndihmon të merrni parasysh mundësitë tuaja për arsim dhe karrierë dhe t'i keni më të qarta planet tuaja në faza të ndryshme të jetës.
- Një seancë udhëzuese individuale zgjat rreth një orë. Mund të flisni me të njëjtin psikolog një ose disa herë.
- Përveç diskutimeve, udhëzimi mund të përfshijë vlerësime psikologjike, trajnime ose prova në punë dhe detyra.

Mund të merrni më shumë informacion rreth këtyre shërbimeve:

- Nga Shërbimet e punësimit lokale
- Shërbime për të ndihmuar me kërkimin e punës - Kërkimi i punës - Työmarkkinatori (tyomarkkinatori.fi)

Informacione të mëtejshme në lidhje me punësimin në Finlandë, udhëzimet për karrierë, trajnimin dhe kërkimin e punës mund të gjenden në:

- Klientët personalë -Työmarkkinatori
- Udhëzuesi juaj për jetesën në Finlandë (infofinland.fi)
- Kotoutumisentukena.fi

Elinkeino-, liikenne- ja ympäristökeskus

Euroopan unionin osarahoittama